



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/D1-12 Prot.
Nr. Dok. 202100369/12

Tiranë 06/12/2021

Lënda : *Rekomandim për respektimin me korrektesë të akteve normative në fuqi gjatë procedurës së verifikimit për pajisjen e punonjësve të Policisë së Shtetit me CSP.*

DREJTORISË SË SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR
Tiranë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
Tiranë

SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT
Tiranë

MINISTRISË SË BRENDSHME
SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT
Tiranë

Për dijeni : **MINISTRIT TË BRENDSHËM**

Tiranë

Z. D.H.
Drejtoria Vendore e Policisë

Të nderuar,

Sikurse ju kemi vënë në dijeni, në institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi D.H.. Ankuesi shkruan se mban gradën policore “Komisar” dhe ka punuar në Policinë e Shtetit dhe në Shërbimin për Kontrollin e Brendshëm dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme për një periudhë kohore prej 18 vjetësh, duke kryer detyra të ndryshme.

Sipas tij, në datën 02.09.2020 ai është vënë në dijeni të shkresës nr. 83/1 prot., datë 18.08.2020 të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me lëndë: “Njoftim për refuzim të pajisjes me CSP të punonjësit të policisë”. Në pjesën sqaruese të kësaj shkrese evidentohet se Shërbimi për Kontrollin e Brendshëm dhe Ankesat me shkresën nr. 2311/1 prot., datë 12.08.2020 ka bërë me dije Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, se mbi bazën e shkresës nr. 7390, datë 05.08.2020 të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), është refuzuar pajisja e ankuesit D.H. me Certifikatën e Sigurisë së Personelit (CSP).

Ankuesi shkruan se gjatë kohës që ai ka kryer detyrën e Shefit të Seksionit për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm dhe Narkotikëve, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, atij nuk i është kërkuar plotësimi i formularit të vetëdeklarimit dhe pyetësorit të sigurisë për pajisjen me CSP.

Hera e fundit që ai ka plotësuar dokumentacionin për pajisjen me CSP i përket periudhës kur ka ushtruar detyrën e Shefit të Seksionit për Hetimin e Korrupsionit, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë dhe kjo kërkesë mban nr.1329 prot., datë 05.03.2018, e cila i është dërguar Drejtorisë së Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, së bashku me dokumentacionin e plotë.

Në vijim të ankesës ai shkruan se, referuar VKM nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e Rregullores për Sigurimin e Personelit” rezulton se nga strukturat që kanë pasur për detyrë verifikimin e figurës së tij nuk është kryer me korrektesë kjo detyrë ose ajo është kryer me keqdashje pasi janë shkelur disa nene të saj sikurse janë:

a) Neni 6/d i cili parashikon detyrimin e autoriteteve verifikuese që të respektojnë afatet e verifikimit të sigurisë;

b) Neni 15 pikat 1 dhe 2, ku parashikohet detyrimi i autoriteteve verifikuese për të shkëmbyer në mënyrë të ndërsjellë dhe të drejtpërdrejtë informacionet që disponojnë për të gjitha kategoritë e individëve të punësuar apo që do të punësohen në strukturat e SHISH-it, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme; për shoqërimin e dokumentacionit edhe me dokumentin e verifikimit të sigurisë, formular nga struktura përkatëse e cila ka kryer verifikimin e sigurisë, sipas akteve normative në fuqi; dhe se vlerësimi i sigurisë bëhet i bazuar në informacionet e shkëmbyera më parë dhe në mënyrë

të drejtpërdrejtë, në funksion të këtij procesi, ndërmjet SHISH, AISM dhe SHÇBA, në Ministrinë e Brendshme.

c) Neni 18, ku parashikohet afati i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit dhe lëshimit të CSP nga DSIK, i cili është deri në 120 ditë kalendarike. Ndërsa kur verifikimi kryhet në bashkëpunim me autoritetet e sigurimit kombëtar të vendeve të tjera ose kur drejtori i DSIK udhëzon kryerjen e verifikimeve shtesë, ky afat mund të jetë edhe më i gjatë. Sipas këtij neni, ky afat mund të zgjatet edhe 30 ditë kalendarike me kërkesë të arsyetuar të titullarit të autoritetit verifikues dhe miratim të drejtorit të DSIK.

Sipas ankuesit, ai ka aplikuar për pajisjen me CSP në datën 05.03.2018 dhe se afati maksimal prej 150 ditë kalendarike, duke përfshirë edhe zgjatjen e tij me 30 ditë, është plotësuar në datën 05.08.2018, ndërkohë që ai është njoftuar për refuzimin e pajisjes me CSP në datën 02.09.2020, pas gati dy vjet e një muaj me vonesë.

Ankuesi pretendon se i është shkelur e drejta për t'u pajisur me CSP, por referuar nenit 27/2 të VKM së cituar më sipër, njoftimi për vendimin e marrë nga DSIK për refuzim, heqje ose pezullim të përkohshëm të CSP i komunikohet me shkrim titullarit të strukturës kërkuese, i cili ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim titullarit të DSIK-së brenda 15 ditëve për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga DSIK.

Për shkak të refuzimit të pajisjes me CSP, ai është larguar nga detyra e Shefit të Seksionit për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm dhe Narkotikëve, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, por nuk i është dhënë asnjë sqarim se përse i është refuzuar ajo, cilat janë arsyet e marrjes së këtij vendimi tej afatit ligjor dhe përse nuk mban përgjegjësi asnjë person për këtë shkelje ligjore. Pas refuzimit të pajisjes me CSP, në datën 22.09.2020 ai është emëruar në detyrën Shef Seksioni/Specialist, në Sektorin e Komandës dhe Kontrollit në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan. Ndërsa në datën 10.03.2021 është transferuar dhe emëruar në detyrën Shef Seksioni/Specialist, në Sektorin e Komandës dhe Kontrollit në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë.

Gjithashtu ankuesi pretendon se të dhënat dhe informacionet e adresuara apo keqadresuara në emër të tij ose nuk janë verifikuar ose ata që i kanë përpiluar këto informacione kanë shpërdoruar detyrën duke i mbajtur ato më shumë se afati që parashikojnë procedurat informative-gjurmuese të cilat variojnë deri në 6 muaj. Sipas tij, kjo ka sjellë shkelje të hapur të parimit kushtetues të prezumimit të pafajësisë.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese kemi pasur një komunikim të gjerë shkresor me disa institucione. Fillimisht i jemi drejtuar me kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe DSIK.

Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit lidhur me shqetësimet e ngritura nga ankuesi, i parashtruar pyetjet si më poshtë vijon:

1. Cili ka qenë qëndrimi i mbajtur nga ky institucion, si strukturë kërkuese për pajisjen e punonjësit të policisë D.H. me CSP, ndaj vendimit të DSIK, për refuzimin e

pajisjes së këtij punonjësi të Policisë së Shtetit me CSP. A është ushtruar e drejta ligjore e parashikuar në nenin 27/2 të VKM nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e Rregullores për Sigurimin e Personelit”, për bërjen e kërkesës për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga DSIK?

2. Nga disa informacione që janë bërë publike në media, rezulton se gjatë viteve të fundit ka pasur një numër të konsiderueshëm të punonjësve të Policisë së Shtetit të cilëve iu është refuzuar pajisja me CSP nga DSIK. Meqënëse në VKM nr. 188, datë 04.03.2015 nuk parashikohet e drejta e ankimit të individëve të cënuar nga vendimmarrja e DSIK-së, në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave kushtetuese e ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, a keni patur raste kur drejtuesit e Policisë së Shtetit, me cilësinë e titullarit të strukturës kërkuese të kenë paraqitur kërkesë për rishqyrtimin e vendimit të marrë titullarit të DSIK, kur nuk kanë qenë të bindur për vendimin në fjalë?

3. Nëse po, në sa raste është ushtruar kjo e drejtë dhe a janë marrë në konsideratë kërkesat tuaja nga DSIK?

Në përgjigje të kërkesës tonë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr. 1916/1 prot., datë 24.03.2021 ndërmjet të tjerave na informoi se, aplikimi i punonjësit të policisë D.H. ka ardhur nga Drejtoria Vendore e Policisë Korçë dhe është protokolluar në Drejtorinë e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave me nr. 263 prot., datë 05.03.2018. Pasi është ndjekur procedura e verifikimit paraprak është dërguar me shkresën nr. 2/341 prot., datë 26.04.2018, tek SHÇBA, në Ministrinë e Brendshme. Bazuar në nenin 8 të VKM nr. 188, datë 04.03.2015, mënyrat e aplikimit për t’u pajisur një individ me CSP janë *me kërkesë të titullarëve të ministrive...*, prandaj struktura kërkuese nuk është Drejtoria Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Vendimi për refuzimin e pajisjes me CSP, për shtetasin D.H. ka ardhur në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me shkresën nr. 1501, datë 13.08.2020, të SHÇBA në Ministrinë e Brendshme, referuar shkresës nr. 7390 prot., datë 05.08.2020 të DSIK. E drejta ligjore për bërjen e kërkesës për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga DSIK-ja i takon strukturës kërkuese.

Në këtë shkresë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit sqaron se nuk ka informacion lidhur me rastet dhe numrin kërkesave të bëra nga titullarët e strukturave kërkuese për rishqyrtimin e vendimeve të marra nga titullari i DSIK, kur nuk kanë qenë të bindur për vendimet e refuzimit të pajisjes me CSP të punonjësve të policisë, pasi nuk është strukturë kërkuese.

Gjithashtu kjo drejtori nuk ka asnjë informacion edhe lidhur me numrin e rasteve të marrjes në konsideratë kërkesave për rishikimin e vendimeve të refuzimit të pajisjes CSP të punonjësve të policisë nga DSIK.

Në vijim të hetimit administrativ, iu drejtuam Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, strukturë e cila me shkresën nr. 1860/1 prot., datë 13.04.2021, ndërmjet të tjerave jep

shpjegime se, z. D.H. ka plotësuar formularin për pajisjen me CSP në datën 05.03.2018 me nr.1329 prot., pasi në atë kohë kryente detyrën e Shefit të Seksionit për Hetimin e Korrupsionit, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë.

Në datën 30.05.2019, z. D.H. me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 329/1, është transferuar në detyrën e Shefit të Seksionit për Hetimin e Trafikut të Paligjshëm dhe Narkotikëve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan.

Vendimi për refuzimin e pajisjes me CSP nga DSIK është dhënë në datën 05.08.2020 dhe njoftimi është bërë në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, ku z. D.H. gjatë asaj periudhe kohore ishte punonjës.

Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, si struktura nga ku është bërë aplikimi, nuk ka pasur dijeni pasi nuk është informuar për refuzimin për pajisjen e tij me CSP. Për këtë arsye kjo drejtori nuk ka bërë kërkesë DSIK-së për rishqyrtimin e vendimit të marrë ndaj tij.

Po ashtu, kjo drejtori na informoi se gjatë dy viteve të fundit DSIK-ja ka refuzuar pajisjen me CSP për 7 punonjës policie të kësaj strukture, por për asnjë rast nuk është bërë kërkesë në DSIK për rishqyrtimin e vendimit të refuzimit sepse nuk ka pasur dyshime për vendimin e refuzimit të dhënë nga ky institucion.

Ndërsa, DSIK-ja në përgjigjen dërguar institucionit tonë me shkresën nr. 1063 prot., datë 30.03.2021, nuk ka bërë sqarime lidhur me shkaqet ligjore dhe provat në të cilat është mbështetur vendimi për refuzimin e pajisjes me CSP të punonjësit të policisë D.H.. Në lidhje me pretendimin e ankuesit D.H. se vendimmarrja është bërë përtej afateve të përcaktuara, na referoi në nenin 18 “Afatet e kryerjes së verifikimeve të sigurisë” të VKM nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e Rregullores për Sigurimin e Personelit” ku parashikohet se:

“Afati i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit dhe lëshimit të CSP nga DSIK është deri në 120 ditë kalendarike. Brenda kësaj periudhe përfshihen edhe afatet e verifikimit të sigurisë nga ana e autoriteteve verifikuese. Ky afat mund të jetë më i gjatë kur verifikimet kushtëzohen nga kryerja e procedurave në bashkëpunim me autoritetet e sigurimit kombëtar të vendeve të tjera ose kur drejtori i DSIK-së udhëzon kryerjen e verifikimeve shtesë”.

Referuar sa më sipër, DSIK me qëllim verifikimin e saktë, të plotë, të thellë dhe për të qenë objektiv në vendimmarrje, në mbështetje të nenit 18, të VKM të cituar më sipër ka kryer verifikime shtesë. Në mbështetje të kësaj VKM, kryerja e verifikimeve shtesë nuk ka një afat të caktuar.

Në mënyrë që DSIK-ja të rishqyrtojë vendimin e marrë duhet që kërkesa për rishqyrtim të bëhet nga titullari i strukturës kërkuese. Në DSIK nuk është paraqitur asnjë kërkesë me shkrim nga titullari i strukturës kërkuese për rishqyrtimin e vendimit të marrë për z. D.H..

Bazuar në nenin 29 të VKM nr. 188, datë 04.03.2015, aplikanti të cilit i është refuzuar CSP ka të drejtë të riaplikojë përsëri me kusht që të ketë kaluar një vit kalendarik nga data e shkresës njoftuese për heqjen ose refuzimin e CSP.

Përveç sa më lart në këtë përgjigje u informuam se, aplikanti në çdo rast ka të drejtë të ankimojë vendimin në rrugë gjyqësore.

Meqënëse informacioni i dërguar nga DSIK-ja nuk ishte shterues, me shkresën nr. K2/D1-8 prot., datë 30.04.2021 i kërkuam këtij institucioni informacion shtesë duke parashtruar pyetjet si më poshtë:

1. Cilat kanë qenë arsyet dhe shkaqet ligjore, si dhe provat në të cilat është mbështetur vendimi për refuzimin e pajisjes me CSP të punonjësit të policisë D.H.?
2. Në cilën datë është regjistruar në këtë institucion aplikimi i ankuesit për t'u pajisur me CSP?
3. Në cilën datë është marrë vendimi, akti administrativ, për refuzimin e pajisjes së tij me CSP?
4. Cila është baza ligjore ku parashikohet e drejta e ushtrimit të ankimit në gjykatë nga personat të cilëve iu refuzohet pajisja me CSP?

Së bashku me informacionin kërkuam edhe dërgimin e një kopjeje të aktit administrativ të marrë nga ky institucion për refuzimin e pajisjes me CSP të shtetasit D.H..

DSIK-ja me shkresën nr. 1548 prot., datë 12.05.2021 na sqaron mbi pyetjet si vijon:

“1. Në lidhje me kërkesën e parë, DSIK është mbështetur në shkaqet ligjore të përcaktuara në nenet 13 “Kërkesat e përgjithshme të vlerësimit të sigurisë” dhe 14 “Kriteret themelore të vlerësimit të sigurisë” të VKM nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personelit”. Vlerësimi i sigurisë nga DSIK është bazuar në informacione të klasifikuara, të përfutuara nga autoritetet verifikuese.

2. Në lidhje me kërkesën e dytë, në DSIK kërkesa për pajisjen nme Certifikatën e Sigurisë të Personelit (CSP) është depozituar **në datën 26.11.2018.**

3. Në lidhje me kërkesën e tretë, vendimi për refuzimin e CSP është marrë **në datën 05.08.2020.**

Referuar sa më sipër, DSIK me qëllim verifikimin e saktë, të plotë, të thellë dhe për një vendimmarrje sa më objektive, në mbështetje të nenit 18 të VKM nr. 188, datë 04.03.2015, ku përcaktohet se:

“Afat i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit dhe lëshimit të CSP nga DSIK është deri në 120 ditë kalendarike. Brenda kësaj periudhe përfshihen edhe afatet e verifikimit të sigurisë nga ana e autoriteteve verifikuese. Ky afat mund të jetë më i gjatë kur verifikimet kushtëzohen nga kryerja e procedurave në bashkëpunim me autoritetet e sigurimit kombëtar të vendeve të tjera ose kur drejtori i DSIK-së udhëzon kryerjen e verifikimeve shtesë”, ka kryer verifikime shtesë. Kryerja e verifikimeve shtesë nuk ka një afat të caktuar. Kryerja e verifikimeve shtesë në rastin konkret është bërë me qëllim sqarimin e informacioneve në ngarkim të aplikuesit. Pavarësisht verifikimeve shtesë, nuk u përfatuan të dhëna në favor të aplikantit.

4. Në lidhje me kërkesën e katërt, e drejta e ankimit në gjykatë parashikohet në nenin 42, pika 2 të Kushtetutës ku parashikohet se:

“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.

Së bashku me informacionin shtesë, DSIK na dërgoi edhe fotokopjen e vendimit nr. 225, datë 05.08.2020 “Për refuzimin e Certifikatës së Sigurimit të Personelit për z. D.H.”.

Për të bërë të mundur një hetim administrativ të plotë të kësaj ankese, me shkresën nr. K2/D1-9 prot., datë 30.04.2021, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (SHÇBA) i kërkuam informacion lidhur:

- Me veprimet verifikuese të kryera nga ky organ në lidhje me punonjësin e policisë D.H. pas dërgimit nga Drejtoria e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të shkresës nr. 263 prot., datë 05.03.2018;
- Nëse kanë bërë verifikime lidhur me sigurinë e shtetasit D.H. dhe çfarë materialesh janë gjetur në ngarkim të tij;
- Në cilin institucion është dërguar dokumentacioni përkatës lidhur me pajisjen e shtetasit D.H. me CSP, numri dhe data e shkresës përkatëse.

Kjo drejtori, me shkresën nr. 878/1 prot., datë 14.05.2021 ndërmjet të tjerave na informoi se SHÇBA ka nisur procedurën e verifikimit të sigurisë për aplikantin D.H., pas kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dërguar me shkresën nr. 2/351, datë 26.04.2018. Ky shërbim i ka kërkuar informacion Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH) në datën 10.05.2018.

DPPSH ka dërguar përgjigje me shkresën nr. 6044/1, datë 22.05.2018, ndërsa SHISH ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 1836/22 prot., datë 01.10.2018.

Me qëllim vlerësimin sa më objektiv dhe përcjelljen e informacionit të plotë mbi verifikimet e sigurisë për subjektin D.H., SHÇBA-ja i ka kërkuar informacione sigurie shtesë SHISH-it, i cili ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 4188/1 prot., datë 31.10.2018.

Pas kryerjes së verifikimeve të plota në bashkëpunim me SHISH dhe DPPSH, SHÇBA në mbështetje të VKM nr. 188, datë 04.03.2015, me shkresën nr. 1602/2 prot., datë 22.11.2018, ka relatuar pranë DSIK-së praktikën dokumentare me verifikimet e kryera për punonjësin e policisë D.H..

Në vijim, DSIK-ja me shkresën nr. 11769 prot., datë 22.11.2019 i ka kërkuar SHÇBA kryerjen e verifikimeve shtesë për këtë aplikant. Duke qenë se verifikimet e kërkuara nga DSIK kanë qenë të një natyre komplekse, ku kërkohej edhe angazhimi i strukturave të SHÇBA në terren, periudha e kryerjes së tyre ka zgjatur rreth tre muaj. Me shkresën nr. 2321/1 prot., datë 17.03.2020, SHÇBA i ka kthyer përgjigje DSIK për verifikimet shtesë.

Gjithashtu në këtë shkresë u informuam se DSIK me shkresën nr. 7390 prot., datë 05.08.2020 ka njoftuar Ministrin e Brendshëm dhe Drejtorin e Përgjithshëm të SHÇBA lidhur me vendimin për refuzimin e Certifikatës së Sigurisë të Personelit për punonjësin e policisë D.H.. Ky njoftim i është bërë i ditur Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit me shkresën nr. 2311/1 prot., datë 12.08.2020.

Pas shqyrtimit të kësaj ankese, analizimit dhe vlerësimin të përgjigjeve të ardhura në institucionin tonë të cilat i cituam më sipër si dhe referimit në VKM nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e Rregullores për Sigurimin e Personelit” dhe Kodin e Procedurës Administrative konstatojmë se:

1. Në nenin 8/a “Mënyrat e aplikimit për t’u pajisur me CSP” të VKM nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e Rregullores për Sigurimin e Personelit” parashikohet se:

“Mënyrat e aplikimit për të pajisur një individ me CSP janë, si më poshtë:

a) Me kërkesë të titullarëve të ministrive dhe institucioneve shtetërore ose personave të autorizuar për punonjësit dhe stafet e tyre, të kontraktuarit ose kategoritë e individëve të parashikuar për të marrë pjesë në një prokurim të klasifikuar;”

Referuar dispozitës së cituar më sipër rezulton se në rastin e punonjësit të policisë D.H., struktura kërkuese për pajisjen e tij me CSP është Drejtoria Vendore e Policisë Korçë.

2. Referuar nenit 27 “Refuzimi, heqja dhe pezullimi i përkohshëm i CSP”, paragrafi i dytë, të VKM nr. 188, datë 04.03.2015 rezulton se, *njoftimi për vendimin e marrë nga DSIK-ja për refuzim, heqje ose pezullim të përkohshëm të CSP-së i komunikohet me shkrim titullarit të strukturës kërkuese, i cili ka të drejtë të paraqesë kërkesë me shkrim për*

rishqyrtimin e vendimit të marrë nga DSIK. Por sipas ankuesit dhe referuar shkresës nr. 83/1 prot., datë 18.08.2020, me lëndë “Njoftim për refuzimin të pajisjes me CSP të një punonjësi policie”, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, drejtuar DVP Elbasan, rezulton se në këtë rast njoftimi nga DSIK nuk i është bërë strukturës kërkuese, konkretisht Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, por Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan. Ky njoftim, kësaj të fundit, i është bërë nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila është njoftuar nga SHÇBA-ja në Ministrinë e Brendshme. Ndërsa kjo e fundit është njoftuar nga DSIK drejtpërdrejtë.

Sikurse rezulton edhe nga korrespondenca e përshkruar më sipër, struktura kërkuese nuk është njoftuar lidhur me refuzimin e pajisjes me certifikatë të shtetasit D.H., as nga DSIK-ja, as nga Ministria e Brendshme apo SHÇBA-ja dhe as nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Kjo ka sjellë si pasojë mos dhënien e mundësisë strukturës kërkuese për ushtrimin e të drejtës së ankimit administrativ ndaj vendimit të marrë nga DSIK për rastin konkret, nëse do të vlerësonte se ai ishte i padrejtë. Gjithashtu njoftimi i vendimit të DSIK për refuzimin e pajisjes me CSP të ankuesit, është bërë duke kaluar nëpërmjet disa strukturave.

3. Qëndrimi i mbajtur nga DSIK-ja, se në rastin e ankuesit D.H. nuk është shkelur afati ligjor sepse zgjatja e tij është bërë me qëllim verifikimin e saktë, të plotë, të thellë dhe për të qenë objektiv në vendimmarrje, nuk është i bazuar në ligj. Gjithashtu edhe arsyetimi se ndaj tij janë kryer verifikime shtesë dhe se në mbështetje të nenit 18, të VKM të cituar më sipër, në rastet e kryerjes së verifikimeve shtesë nuk ka një afat të caktuar, nuk është korrekt.

Ndonëse në përgjigjen e dërguar pranë institucionit tonë, DSIK-ja i referohet nenit 18 të VKM nr. 188, datë 04.03.2015, por përmbajtjen e këtij neni e ka cituar të pjesshme dhe jo të plotë.

Sipas paragrafit të parë të këtij neni, afati i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit dhe lëshimit të CSP nga DSIK është deri në 120 ditë kalendarike. Brenda kësaj periudhe përfshihen edhe afatet e verifikimit të sigurisë nga ana e autoriteteve verifikuese.

Në paragrafin e dytë të tij parashikohet se, ky afat mund të jetë më i gjatë kur verifikimet kushtëzohen nga kryerja e procedurave në bashkëpunim me autoritetet e sigurimit kombëtar të vendeve të tjera ose kur drejtori i DSIK udhëzon kryerjen e verifikimeve shtesë.

Në paragrafin e tretë parashikohet se, afati i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit fillon vetëm pas paraqitjes së plotë dhe pranimit të dokumentacionit nga ana e DSIK.

Më tej, në paragrafin e katërt përcaktohet se, autoriteti verifikues dhe çdo strukturë tjetër shtetërore, që merr kërkesën e paraqitur nga DSIK për të kryer verifikimin e sigurisë, ka detyrimin të kryejë procedurat dhe të kthejë përgjigje duke dhënë informacionin e kërkuar me shkrim, jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e marrjes së kërkesës.

Ndërsa në paragrafin e pestë të këtij neni parashikohet se, për raste të veçanta, me kërkesë të arsyetuar të titullarit të autoritetit verifikues dhe me miratim të drejtorit të DSIK, ky afat mund të zgjatet edhe 30 ditë të tjera kalendarike.

Pra, sikurse rezulton në mënyrë të qartë nga përmbajtja e këtij neni, afati i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit për pajisjen e një personi me CSP, duke përfshirë edhe zgjatjen e tij me 30 ditë për raste të veçanta është 150 ditë kalendarike nga data e paraqitjes së plotë dhe pranimit të dokumentacionit nga DSIK.

Arsyetimi i bërë në përgjigjen e dërguar nga DSIK, se ndaj ankuesit janë kryer verifikime shtesë dhe se për kryerjen e tyre nuk ka një afat të caktuar në nenin 18 të VKM në fjalë, nuk është korrekt dhe jo i mbështetur në ligj. Gjithashtu nga DSIK nuk jemi informuar se në rastin e shtetasit D.H. të ketë pasur ndonjë kërkesë të arsyetuar nga ndonjë prej titullarëve të autoriteteve verifikuese dhe miratim të drejtorit të DSIK, për zgjatjen e këtij afati edhe 30 ditë të tjera kalendarike.

Për rrjedhojë, vendimi i DSIK-së¹ për refuzimin e pajisjes më CSP të punonjësit të policisë D.H., duke u referuar në procedurën e ndjekur rezulton se është marrë duke mos respektuar ligjin, sepse procedura e verifikimit të sigurisë së tij është zhvilluar tej afatit të arsyeshëm dhe për më tepër, tej afatit ligjor maksimal brenda të cilit duhej të kishte përfunduar procesi administrativ.

Theksojmë se organet publike gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre duhet të zbatojnë parimin e ligjshmërisë të parashikuar në nenin 4 të Kodit të Procedurës Administrative (KPA). Sipas këtij parimi ato duhet të veprojnë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. Po ashtu në këtë veprimtari ato duhet të mbajnë parasysh se të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor. Pra, veprimtaria e organeve administrative fillon dhe mbaron tek ligji.

Sjellim në vëmendje se veprimet e kryera nga DSIK për verifikimin e sigurisë së personit për lëshimin, refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP, përbëjnë një proces administrativ të mirëfilltë, i cili rregullohet nga KPA. Palët e përfshira në këtë proces janë

¹ Theksojmë se nuk ka qenë objekt i hetimit tonë administrativ vlerësimi nëse ankuesi i përmbush kriteret për t'u pajisur më CSP, bazueshmëria e vendimit në informacion dhe prova ligjore, por **vetëm nëse është respektuar procedura përkatëse** nga të gjitha strukturat e përfshira në këtë proces.

të detyruara të zbatojnë me korrektesë detyrimet dhe të drejtat e parashikuara në dispozitat e këtij Kodi. Më konkretisht, në nenin 91 të KPA “Afati për përfundimin e procedurës administrative” parashikohet se:

“1. Procedura administrative, e nisur me kërkesë, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda afatit të përcaktuar nga ligji i posaçëm.

2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë.”

Për çështjen, objekt i hetimit tonë, që po trajtojmë “ligji i posaçëm” është VKM nr. 188, datë 04.03.2015. Në nenin 18 të këtij vendimi parashikohet afati i përfundimit të verifikimit të sigurisë që do të thotë se ky është afati i përfundimit të procedurës administrative. Sikurse parashtrua më sipër, afati i përgjithshëm për kryerjen e procedurave të verifikimit për pajisjen e një personi me CSP, duke përfshirë edhe zgjatjen e tij për raste të veçanta është 150 ditë kalendarike nga data e paraqitjes së plotë dhe pranimit të dokumentacionit nga DSIK.

Sqarojmë se në rastin në trajtim, pas verifikimeve të plota të bëra nga SHÇBA në bashkëpunim me SHISH dhe DPPSH, me shkresën nr. 1602/2, datë 22.11.2018 dokumentacioni i është përcjellë DSIK. Në këtë institucion aplikimi dhe dokumentacioni verifikues për punonjësin e policisë D.H. është regjistruar (pranuar) **në datën 26.11.2018**, e cila është edhe data e fillimit të përlllogaritjes së afatit të kryerjes së procedurave të verifikimit të sigurisë së tij nga DSIK-ja. Ndërsa vendimi nga DSIK-ja për refuzimin e CSP është marrë **në datën 05.08.2020**.

Duke iu referuar afatit maksimal të parashikuar në nenin 18 të VKM nr. 188, datë 04.03.2015, ***procedura administrative duhet të kishte përfunduar brenda 120 ditëve kalendarike dmth brenda muajit mars 2019***, sepse nga titullarët e autoriteteve verifikuese të SHISH-it dhe SHÇBA-së nuk është bërë kërkesë e arsyetuar për zgjatjen e afatit të verifikimit edhe 30 ditë kalendarike tej afatit 45 ditor, e cila duhej miratuar më tej nga drejtori i DSIK-së. Në fakt, duke iu referuar dokumentacionit të administruar nga ana jonë rezulton se ***procedura administrative ka përfunduar në datën 05.08.2020. Pra, ajo ka zgjatur 1 vit, 9 muaj e 10 ditë***, duke shkelur në këtë mënyrë hapur detyrimin ligjor lidhur me afatin e përfundimit të saj. Ndonëse gjatë kësaj periudhe kohore këto institucione kanë punuar në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme të shkaktuar nga COVID-19, sidoqoftë tejkalimi i afatit të verifikimit është tej një afati të arsyeshëm për përfundimin e një procesi administrativ.

Sjellim në vëmendje se sipas nenit 107 Kodit të Procedurës Administrative, *akti administrativ është i ligjshëm nëse është nxjerrë nga organi publik kompetent, në përputhje me parimet dhe kërkesat ligjore të parashikuara në këtë Kod, si dhe legjislacionin në fuqi.*

Në rastin konkret, duke iu referuar vendimit nr. 255, datë 05.08.2020 “Për refuzimin e Certifikatës së Sigurisë të Personelit për z. D.H.” të DSIK, rezulton se përveç shkeljes së afatit të përfundimit të procedurës administrative, akti administrativ është edhe në kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenet 99² dhe 100³ të KPA. Atij i mungojnë disa nga elementët e domosdoshëm të parashikuar në këto dispozita sikurse janë: *qëllimi, pjesa hyrëse (emri e organit publik që nxjerr aktin; palët të cilave u drejtohet akti; pjesa arsyetuese; e drejta e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit).* Pjesa arsyetuese duhet të përmbajë: *shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti; shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave; dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast.*

Ndodhur në këto rrethana faktike e ligjore, referuar nenit 109/b/c të Kodit të Procedurës Administrative⁴, rezulton se akti administrativ i nxjerrë nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (vendimi nr. 255, datë 05.08.2020 “Për refuzimin e Certifikatës së Sigurisë të Personelit për z. D.H.”) është i paligjshëm sepse vjen në

² Neni 99 “Kërkesat e formës së aktit administrativ të shkruar në letër ose elektronik”

1. Në çdo rast akti administrativ duhet të tregojë qëllimin e tij.

2. Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik përmban:

a) pjesën hyrëse, që përmban:

i) emrin e organit publik që nxjerr aktin;

ii) palët të cilave u drejtohet akti;

iii) datën e miratimit;

iv) bazën ligjore;

b) pjesën arsyetuese:

c) dispozitivin që tregon:

i) pjesën urdhëruese që tregon çfarë është vendosur;

ii) kohën e hyrjes në fuqi të aktit;

iii) të drejtën e ankimit, përfshirë organin publik apo gjykatën ku mund të paraqitet ankimi, mjetet e ankimit, afatin dhe mënyrën e përlllogaritjes së tij për paraqitjen e ankimit.

³ Neni 100 “Arsyetimi i aktit”

Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik, si dhe akti administrativ i konfirmuar, sipas nenit 98, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, duhet të jetë i arsyetuar. Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:

a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti;

b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave;

c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast;

ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.”

⁴ Neni 109 “Paligjshmëria e aktit administrativ”

Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;

b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;

c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;

ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;

d) është në kundërshtim me ligjin material;

dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo

e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenin 18 të VKM nr. 188, datë 04.03.2015 dhe me nenet 91, 99 e 100 të KPA.

4. Në analizën dhe vlerësimin tonë, shkelja e afatit ligjor të përfundimit të procedurës administrative për verifikimin e sigurisë të punonjësit të policisë D.H. nga DSIK-ja ka ardhur edhe për shkak të mungesës së korrektesës për respektimin e afatit për dërgimin e informacioneve të nevojshme lidhur me aplikantin nga SHISH-i dhe SHÇBA-ja, me cilësinë e autoriteteve verifikuese të parashikuara në VKM nr. 188, datë 04.03.2015.

Nga përgjigjja e dërguar institucionit tonë nga SHÇBA-ja me shkresën nr. 878/1 prot., datë 14.05.2021, provohet se ky organ ka nisur procedurën e verifikimit të sigurisë për aplikantin D.H., pas kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dërguar me shkresën nr. 2/351, datë 26.04.2018. SHÇBA-ja i ka kërkuar informacion SHISH-it në datën 10.05.2018 dhe përgjigjja i është dërguar me shkresën nr. 1836/22 prot., datë 01.10.2018. Pra, **pas 4 muaj e 20 ditësh**. Ndonëse përgjigjja e SHISH-it i ka ardhur me shumë vonesë, ka qenë e nevojshme edhe kërkimi i një informacioni sigurie shtesë nga ky organ, i cili ka kthyer përgjigje SHÇBA-së me shkresën nr. 4188/1 prot., datë 31.10.2018.

Pas kryerjes së verifikimeve të plota në bashkëpunim me SHISH dhe DPPSH, SHÇBA-ja me shkresën nr. 1602/2 prot., datë 22.11.2018, ka relatuar pranë DSIK-së praktikën dokumentare me verifikimet e kryera për punonjësin e policisë D.H..

DSIK-ja, pavarësisht se e ka regjistruar (pranuar) dokumentacionin e dërguar nga SHÇBA-ja për aplikantin D.H. **në datën 26.11.2018**, në vijim me shkresën nr. 11769 prot., datë 22.11.2019 i ka kërkuar SHÇBA-së kryerjen e verifikimeve shtesë për këtë aplikant. Rezulton pra, **se ka kërkuar informacionin shtesë në mënyrë të paarsyeshme pas 1 viti pa 4 ditë**.

Në vijimësi të komunikimit shkresor të këtyre strukturave, SHÇBA-ja ia ka dërguar informacionin shtesë DSIK-së me shkresën nr. 2321/1 prot., datë 17.03.2020. Pra, **pas 4 muajve pa 5 ditë** duke u justifikuar se procesi i verifikimit ka qenë i një natyre komplekse dhe se kërkohej edhe angazhimi i strukturave të këtij shërbimi në terren.

Sjellim në vëmendje përmbajtjen e nenit 18, paragrafi i katërt, të VKM nr. 188, datë 04.03.2015 ku parashikohet se, autoriteti verifikues dhe çdo strukturë tjetër shtetërore, që merr kërkesën e paraqitur nga DSIK për të kryer verifikimin e sigurisë, ka detyrimin të kryejë procedurat dhe të kthejë përgjigje duke dhënë informacionin e kërkuar me shkrim, jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e marrjes së kërkesës. Konstatohet se, ky afat është shkelur në mënyrë të hapur si nga SHISH-i ashtu edhe nga SHÇBA-ja.

Ndërsa në paragrafin e pestë të nenit 18 të kësaj VKM-je parashikohet se, *për raste të veçanta, me kërkesë të arsyetuar të titullarit të autoritetit verifikues dhe me miratim të drejtorit të DSIK, ky afat mund të zgjatet edhe 30 ditë të tjera kalendarike*. Por, nga dokumentacioni i administruar nga ana jonë gjatë këtij hetimi administrativ nuk rezulton

që nga titullarët e këtyre autoriteteve (institucioneve) verifikuese SHISH dhe SHÇBA të jetë zbatuar ky parashikim ligjor, duke bërë kërkesë të arsyetuar për zgjatjen e afatit të verifikimit edhe 30 ditë kalendarike tej afatit 45 ditor, e cila duhej miratuar nga drejtori i DSIK-së. Ne vlerësojmë se ky qëndrim i mbajtur nga këto institucione e bën procesin e verifikimit të cenueshëm.

5. Sikurse parashtruam edhe më sipër, në nenin 27/2 të VKM-së nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e Rregullores për Sigurimin e Personelit”, është parashikuar e drejta ligjore e strukturës kërkuese për bërjen e kërkesës për rishqyrtimin e vendimit të marrë nga DSIK tek titullari i saj, i cili e shqyrton dhe vendos për kërkesën e paraqitur brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e pranimit të saj. Në rastet e mospajtimit me përgjigjen e titullarit të DSIK-së, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit, titullari i strukturës kërkuese ka të drejtë ta ankimojë atë me shkrim te Kryeministri. Kryeministri, pas marrjes së ankesës, brenda 30 ditëve kalendarike, shprehet me akt të veçantë i cili është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim nga DSIK-ja dhe struktura që ka bërë ankimin. Nga përgjigjet e dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, në të cilën vetëm gjatë dy viteve të fundit ka pasur 7 raste të refuzimit të pajisjes me CSP të punonjësve të kësaj strukture vendore, nuk rezulton që të jetë ushtruar kjo e drejtë ligjore për ndonjërin prej këtyre rasteve.

Pavarësisht arsyeve dhe rrethanave se përse nuk është ushtruar kjo e drejtë nga subjektet kërkuese, për të shteruar mjetet e ankimit administrativ, ata që janë cenuar drejtpërdrejtë nga kjo procedurë janë punonjësit e policisë. Këta të fundit përveç se cenohen nga ana morale, privohen edhe nga ana profesionale sepse nuk u lejohej të punojnë në detyra në të cilat kanë akses me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”. Për rrjedhojë ata cenohen edhe në ecurinë në karrierë në strukturat e Policisë së Shtetit dhe në struktura të tjera të administratës publike në të cilat administrohet informacion i klasifikuar.

Në përgjigjen e dërguar nga DSIK informohemi se aplikanti në çdo rast ka të drejtë të ankimojë vendimin në rrugë gjyqësore, duke na referuar nenin 42/2 të Kushtetutës. Lidhur me këtë referim sqarojmë se, në këtë nen kushtetues parashikohet parimi i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Më konkretisht parashikohet se: *“Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”*. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ. Në këtë kuptim, ajo është shprehur se çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë.

Nisur nga ky rast sjellim në vëmendje se, referuar legjislacionit tonë të brendshëm, zhvillimi i një procesi administrativ i cili fillon me kërkesën e palëve të interesuara është jo vetëm një e drejtë por edhe detyrim i organeve të administratës publike. Nëpërmjet këtij procesi organet e administratës publike kanë mundësinë dhe detyrimin që të korigjojnë

shkeljet ligjore të kryera ndaj të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve dhe personave të tretë gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative të strukturave apo punonjësve të tyre. Ato duhet të sigurojnë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve, duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor. Nëse palët e interesuara nuk do t'i rivendosin në vend në rrugë administrative të drejtat dhe interesat e shkeluara, ato kanë të drejtë që t'i drejtohen organeve gjyqësore me kërkesë padi.

Ne vlerësojmë se korigjimi i akteve administrative të nxjera më parë nëpërmjet procesit administrativ duke vendosur sipas rastit anulimin, shfuqizimin apo ndryshimin e tyre ka disa përparësi ndaj procesit gjyqësor të cilat nuk duhen neglizhuar, sikurse mund të përmendim: rivendosja në vend e të drejtave të shkelura shtetasve apo personave të tretë brenda një kohe relativisht të shkurtër; është më efektive sepse i kursen buxhetit të shtetit shpenzimet gjyqësore dhe ato përmbartimore nga zhvillimi i proceseve gjyqësore, si dhe vënia në ekzekutim i vendimeve gjyqësore; ulet ndjeshëm ngarkesa e gjykatave nga çështjet që kanë objekt padie zgjidhjen e konflikteve administrative; krijohet një imazh pozitiv në publik ndaj organeve të administratës publike si struktura në shërbim të publikut dhe jo kundërshtar të tij, etj.

Theksojmë se nga leximi me kujdes i VKM nr. 188, datë 04.03.2015, konstatohet se nuk parashikohet as e drejta e ankimit administrativ dhe as e drejta e ankimit gjyqësor e personit ndaj vendimit të DSIK-së për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP, në rastet kur nëpërmjet autoriteteve verifikuese ose/dhe strukturave shtetërore të përfshira në procesin e verifikimit është përftuar informacion, sipas të cilit vlerësohet se pajisja ose mbajtja e mëtejshme e CSP nga një individ i caktuar përbën rrezik të papranueshëm sigurie, referuar neneve 13 e 14, të kësaj rregulloreje.

Në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave kushtetuese e ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit, por jo vetëm të atyre, si dhe në zbatim të parimit kushtetues të procesit të rregullt ligjor, ku e drejta e ankimit në rrugë administrative dhe gjyqësore është një nga elementët bazë të tij, vlerësojmë që duhet të bëhen ndryshimet përkatëse duke e përmirësuar përmbajtjen e këtij akti normativ.

6. Ndërkohë vlerësojmë se, nga strukturat kërkuese për pajisjen me CSP të punonjësve të Policisë së Shtetit nuk është mbajtur një qëndrim aktiv në rastet e refuzimit për t'u pajisur me këtë dokument nga DSIK-ja. Fakti i refuzimit, heqjes ose pezullimit të përkohshëm të CSP për një numër jo të vogël të punonjësve të policisë, është shqetësues jo vetëm për subjektet e cenuara drejtpërdrejtë nga vendimet e DSIK-së, por sjell pasoja edhe ndaj strukturave të Policisë së Shtetit. Ky proces ka larguar nga sektorë të rëndësishëm të këtij organi disa nga punonjësit e policisë të cilët janë trajnuar nga ana profesionale brenda dhe jashtë vendit dhe kanë eksperiencë të konsiderueshme pune, në veçanti në sektorin e policisë kriminale, duke sjellë si pasojë edhe uljen e performancës së këtij sektori dhe të vetë organit të Policisë së Shtetit.

Ky shqetësim bëhet edhe më evident për faktin se referuar nenit 27/2 të VKM-së nr. 188, datë 04.03.2015, është vetëm në diskrecionin e strukturës kërkuese bërja e kërkesës për rishqyrtimin e vendimit për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP-së punonjësve të policisë nga DSIK-ja tek titullari i saj dhe në rastet e mospajtit me përgjigjen e titullarit të DSIK-së, titullari i strukturës kërkuese ka të drejtë ta ankimojë atë me shkrim te Kryeministri. Pra, ky parashikim ligjor e bënë të domosdoshëm ushtrimin e kësaj të drejte nga titullarët e strukturave kërkuese qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit në veçanti dhe të administratës publike në përgjithësi për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e punonjësve të tyre por edhe të institucioneve që apo përfaqësojnë. Sqarojmë se ky qëndrim duhet mbajtur në ato raste dhe për ata punonjës për të cilët ka mospajtim të tyre me vendimet e DSIK-së por edhe të Kryeministrit dhe kur vlerësohet se ato janë të padrejta.

Ne vlerësojmë se, pavarësisht faktit që nga ana jonë po shqyrtohet vetëm një ankesë që lidhet me këtë shqetësim e bërë nga punonjësi i Policisë së Shtetit i përmendur më sipër, rasti duhet të trajtohet në nivel të përgjithshëm nga strukturat e përfshira në procesin e verifikimit të pajisjes me CSP të punonjësve të administratës publike. Si shkak për këtë vlerësim kanë shërbyer edhe përgjigjet e DSIK-së dhe SHÇBA-së, sipas të cilave nuk janë shkëluar afatet ligjore gjatë procedurës administrative të refuzimit të pajisjes me CSP të personit në fjalë. Ky fakt është tregues i një qasjeje shqetësuese të strukturave të administratës publike ndaj detyrimeve ligjore dhe institucionit të Avokatit të Popullit.

Theksojmë se institucioni i Avokatit të Popullit nuk është kundër procesit të verifikimit të sigurisë së punonjësve të Policisë së Shtetit. Madje, e vlerëson atë si një proces që ka si qëllim verifikimin e përshtatshmërisë së punonjësve të këtij organi, rritjen e besimit të publikut tek Policia e Shtetit, i cili është një ndër parimet kryesore për kryerjen me sukses të misionit të saj ligjor *për ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut*. Pra, punonjësit të cilët nuk janë të përshtatshëm në aspektin e sigurisë duhet të largohen nga ato struktura që kanë lidhje me informacionin e klasifikuar apo edhe nga vetë Policia e Shtetit, sepse në këtë mënyrë i bëhet një shërbim efikas si vetë këtij institucioni por edhe publikut në tërësi. Në këtë kuadër, ne çmojmë se **procedura që duhet të ndiqet në këto raste nga DSIK-ja dhe autoritetet shtetërorë të ngarkuar për të kryer verifikimet e sigurisë, të realizohet duke respektuar ligjin dhe brenda afateve të përcaktuara**. Gjithashtu, vendimmarrja për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP-së, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të mbështetet pas përfutimit të një informacioni të plotë, të analizuar dhe të bazuar në dokumente origjinale ose/dhe dyshime të arsyeshme të mbështetura gjithmonë tek informacionet e vërtetuara⁵, pra pas informacioneve të verifikuara në mënyrë shteruese nga strukturat përkatëse. Në të kundërt,

⁵ Sipas nenit 5/3 “Detyrimet e autoriteteve verifikuese dhe të institucioneve të tjera shtetërore” të VKM nr. 188, datë 04.03.2015.

procesi i verifikimit e humb qëllimin e tij dhe besueshmërinë, sjell demotivim të personave të cënuar drejtpërdrejtë por edhe trupës së Policisë së Shtetit në përgjithësi. Për këto arsye mendojmë që strukturat kërkuese të jenë më proaktive duke ushtruar të drejtën e kërkesës për rishikimin e vendimeve të DSIK-së për ato raste që ato kanë bindjen dhe vlerësojnë se vendimet për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP janë të pa bazuara në ligj dhe në prova, sikurse parashikohet në nenin 27/2 të VKM nr. 188, datë 04.03.2015.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; në nenin 21/c të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”*, në nenin 24/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë: b) t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive.”*, si dhe në nenet 108/a/ii/iii; 109/b/c; 110/1/2 dhe 111 të Kodit të Procedurës Administrative, të cilët i kemi cituar më sipër,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) për rishikimin e aktit administrativ, vendimit nr. 255, datë 05.08.2020 *“Për refuzimin e Certifikatës së Sigurisë të Personelit për z. D.H.”*, për t’a plotësuar me elementët e nevojshëm dhe bërë atë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative.
2. Marrjen e masave të nevojshme nga DSIK-ja për respektimin me korrektesë të akteve normative në fuqi gjatë procesit administrativ të verifikimit për pajisjen e punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të personave të tjerë me CSP, lidhur me afatin e përfundimit të tij, arsyetimin e vendimit dhe njoftimin e strukturës kërkuese.
3. Marrjen e masave të nevojshme nga DSIK-ja duke bërë propozim Këshillit të Ministrave për ndryshimin dhe përmirësimin e VKM nr. 188, datë 04.03.2015, në të cilën të parashikohet e drejta e ankimit administrativ dhe gjyqësor e personit ndaj vendimit të DSIK-së për refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP.
4. Marrjen e masave organizative të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe organeve vendore të saj për të mbajtur një qëndrim të arsyetuar lidhur me ushtrimin e të drejtës për bërjen apo jo të kërkesës për rishqyrtimin e vendimit për

refuzimin, heqjen ose pezullimin e përkohshëm të CSP-së punonjësve të policisë nga DSIK-ja tek titullari i saj. Më pas, në rastet e mospajtit me përgjigjet përkatëse nëse ky organ nuk reagon, tek Kryeministri, sikurse parashikohet në nenin 27 të VKM nr. 188, datë 04.03.2015, në fuqi, në ato raste kur vlerësohet se ai është i padrejtë.

5. Marrjen e masave organizative të nevojshme nga Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH) dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA) që me cilësinë e autoriteteve verifikuese të zbatojnë afatet ligjorë të kryerjes së verifikimit të sigurisë së personelit, të parashikuar në nenin 18 të VKM nr. 188, datë 04.03.2015, për dërgimin e informacioneve të sigurisë autoriteteve kërkuese.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi lutemi të na njoftoni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca